



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr.21 -2008
Prishtinë, më 17 shtator 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Riza Smaka, Selvije Halimi dhe Džezair Murati.

Munguan: Branislav Grbiq, Lutfi Haziri, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj dhe Bajram Kosumi.

Të pranishëm: Reshit Gashi – NDI.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

REND DITE

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës
2. Vizita në Burgun e Dubravës

1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për Projektligjin për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës se i plotëson kushtet për procedim të mëtutjeshëm.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Komision njëzëri vendosi që Projektligji për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës të miratohet në parim nga Komisioni

2. Vizita në Burgun e Dubravës

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi me 17 shtator 2008 e vizitoi Burgun e Dubravës Agjenda kësaj vizite ishte:

1. Takimi me autoritetet e Burgut,
2. Vizita e objekteve të Burgut,
3. Biseda me të burgosur.

Komisioni i ka bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e kësaj vizite dhe do të diskutojë me autoritetet e Burgut rreth çështjes së implementimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe çështje të tjera, si biseda me të burgosur, vizita objekteve të burgut dhe për këtë vizitë Komisioni do ta përgatitë një raport.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni